

# STATUTI I SHOQERISE



## "Ideart" SHPK

### Neni 1

Shoqeria "Ideart" shpk, eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe perfaqesohet nga ortaku i vetem Redin Jegeni qe eshte njekohesisht edhe administrator i vetem i saj.

### Neni 2

Shoqeria ka kete statut ne perputhje me aktin e themelimit dhe ligjin Nr.7638 dt.19.11.1992 dhe te ligjit 7667 dt.28.01.1993 si dhe te gjitha aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne poziten juridike te veprimtarise private. Ky statut rregullon edhe poziten juridike te ortakut te vetem me punonjesit ne Shoqeri, tregon te dhenat me rendesi te qarkullimit juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarise se Shoqerise, dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e Shoqerise.

### Neni 3

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

Zhvillimin e aktivitetit tregtar ne fushen e krijimit, publikimit, shtypshkrimit dhe botimeve, botime keto si libra, revista, gazeta, botime shkollore dhe jashteshkollore, botime ne fushen e multim medias, botime informatike, duke bere te mundur prodhimin dhe distribuimin e Kasetave, Videokasetave, CD-ve, DVD-ve, etj.

Zhvillimin e aktivitetit tregtar ne fushen e publicitetit me anen e krijimit te agjensive publicitare, agjensi fotomodelesh, agjensi per organizimin e spektakleve te ndryshme dhe agjensi te tjera te te gjitha llojeve qe lidhen me publicitetin ne pergjithesi.

Te jape asistencë, ne rastet e kerkuara, per qendrat kulturore, bibliotekat e qyteteve dhe shkollave etj.

Veprimtari tregtare ne fushen e ushqimit social, hoteleri, etj.

Operacione tregtare e komisionerie dhe transaksione te ndryshme te çdo lloj malli.

Tregetim, Import-Eksport, me shumice e pakice te artikujve ushqimore, industriale, pajisje elektrike e elektroshtepiake, etj.

Shoqeria mund te kryeje aktivitete te tjera te lidhura ose plotesuese me ato te parat dhe çdo aktivitet tjeter te nevojshem ose te dobishem per qellimin shoqeror.

### Neni 4

Selia e Shoqerise eshte ne adresen, Rr.Thanas Ziko, Nr. 19/1, Tirane. Ajo ka te drejte te hape filiale, dege e perfaqesi ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe Jashte saj, ne perputhje me ligjet e vendit ku ato do te ngrihen.

#### Neni 5



Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ne shumen 100.000 Lek dhe i takon teresisht ortakut te vetem, i cili e ka ndare ate ne 10 kuota, ku secila kuote eshte ne shumen 10.000

Keto kuota dhe mjetet e kapitalit themeltar te Shoqerise shenohen ne librin e llogarise se Shoqerise. Ato jane te shlyeshme dhe te nenshkrueshme dhe depozitohen ne nje nga bankat ne Shqiperi.

Ne librin e llogarise se Shoqerise krijohet "Fondi Themelor i Ortakut te Vetem". Ortaku i vetem nuk kufizohet ne rritjen e kontributit te kapitalit themeltar.

#### Neni 6

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te Shoqerise nuk e pengon Ortakun e vetem te kete pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta te tjera pronesie jashte Shqiperise.

Ortaku i vetem nuk pergjigjet per detyrimet e Shoqerise tej kapitalit te tij themeltar. Po keshtu, Shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut si person fizik tej veprimtarise se shoqerise.

#### Neni 7

Marrja ne pune ne Shoqeri behet me ane te kontrates se punes ku percaktohen te drejtat dhe detyrimet e paleve duke u mbeshtetur edhe ne ligjin per marrdheniet e punes.

#### Neni 8

Shoqeria percakton Fondin Themelor dhe Fondin Rezerve. Gjate veprimtarise se saj ajo mund te percaktoje dhe fonde te tjera.

Fondi Themelor i Shoqerise formohet nga mjetet e investuara nga Ortaku i vetem dhe shfrytezohet nga Shoqeria per kryerjen e veprimtarise se saj si dhe per te miratuar rreziqet, por pas shfrytezimit te Fondit Rezerve.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e Fondit Rezerve dhe cdo fondi tjeter te vecante caktohen nga ortaku i vetem ne rolin e Drejtorit Administrativ.

Detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise mbulohen nga Fondi Rezerve dhe nga Fonde te tjera, ose nga shumat eventuale suplementare qe mund te derdhe Ortaku i vetem, kur keto detyrime nuk mund te mbulohen nga Fondet ekzistuese.

#### Neni 9

Shoqeria me vendim te Ortakut te Vetem mund te pranoje ne te edhe ortake te rinj, te cileve u shiten kuota nga kapitali i Shoqerise ose ofrojne kuota te reja nga jashte.

Neni 10

Shoqeria eshte pronare per ato sende qe gezon kete te drejte, por edhe per te tjera, ne perputhje me objektin dhe qellimin e veprimtarise se saj. Ajo mund te bleje e te shrytezoje edhe te drejta te tjera materiale duke perfshire ketu edhe te drejten per te ofruar pasurite e veta.

Neni 11

Fitimi i realizuar nga Shoqeria merret nga Ortaku i Vetem dhe perdoret ne interes te tij, por edhe per te shtuar kapitalin themeltar.

Neni 12

Rrezikun e humbjeve ne afarizmin e Shoqerise e bart Ortaku i Vetem. Humbjet kompesohen nga e tere pasuria e Shoqerise.

Neni 13

Pasurite e Shoqerise vleresohen ne bilancet e saj ne vlera te shprehura ne Lek, ne perputhje me Ligjin Per Kontabilitetin. Forma e bilanceve dhe e llogarive ekonomike percaktohen nga Ortaku i Vetem ne rolin e Drejtorit Administrativ, duke patur parasysh Ligjin per Kontabilitetin. Bilancet vjetore duhet te paraqiten brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

Neni 14

Organet e Shoqerise jane :

1. Ortaku i vetem
2. Administratori Administrativ - eshte Kordinatori i Shoqerise
3. Komisioni i revizionit ose i ekspertave kontabel.

Neni 15

Ortaku i Vetem eshte organi vendimor ne Shoqeri, i cili percakton drejtimin kryesor te Shoqerise, vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne Statut, per shtimin apo pakesimin e kapitalit, per pranimin e ortakeve te rinj, per emerimin e Administratoreve te deleguar apo Drejtorit Administrativ, per pushimin e veprimtarise se Shoqerise.

Neni 16

Ortaku i Vetem ne rolin e Administratorit ka keto te drejta dhe detyra:

Miraton programet dhe llogarite ekonomike, emeron dhe shkarkon komisionin e Revizionimit, cel leter kredi ne Lek dhe ne valute te huaj, perfaqeson Shoqerine ne te tretet, lidh kontrata, percakton numrin e punonjesve dhe pagat e tyre.

Neni 17

Ortaku i Vetem ne rolin e Drejtorit Administrativ ka keto te drejta dhe detyra: Perfaqeson Shoqerine ne te tretet, vepron ne te gjithe sektoret e Shoqerise per ndjekjen dhe realizimin e veprimtarise se Shoqerise, lidh, nenshkruan ndjek e realizon kontrata te ndryshme, ben emërtimin dhe pushimin e punonjesve nga puna, kur ata shkelin kontraten e punes ose kur veprimet e tyre bien ndesh me interesat e Shoqerise.

Neni 18

Per te kontrolluar veprimtarine financiare apo ate ekonomike tregtare te Shoqerise apo te filialeve te saj, Ortaku i Vetem emeron Komisionin e Revizionimit ose te eksperteve kontabel te perbere nga nje kryetar dhe nga nje ose me shume revizore. Keta emerohen me nje afat te caktuar. Kryetari dhe Revizoret nuk duhet te jene punonjes te Shoqerise apo te filialeve te saj.

Komisioni i Revizionimit ose i eksperteve kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vete para Ortakut te Vetem.

Neni 19

Ortaku i Vetem ka te drejte qe te emeroje Administrator te deleguar eter, te cileve ju jep kompetenca sic jane parashikuar ne nenin 16-17 te ketij Statuti ose edhe detyra te tjera me te cinguar apo kompetenca me shume.

Neni 20

Shoqeria pushon veprimtarine e saj ne cdo rast qe vendos Ortaku i Vetem. Kur vendoset nje gje e tille, Ortaku i Vetem emeron komisionin e likujdimit, i cili duhet te paraqese bilancin e likujdimit.

Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj kur Ortaku i Vetem miraton bilancin e likujdimit. Mjetet financiare te fituara apo kapitali i Shoqerise merret nga Ortaku i Vetem pasi jane bere pagesat kreditore.

Neni 21

Ky Statut permban 21 nene dhe u redaktua ne 4 kopje nga te cilat njera dorezohet ne Zyren e Noterise, Tirane, nje tjeter ne Gjykaten e Rrethit Tirane, nje kopje ne Zyren e Tameseve dhe nje kopje mbahet ne dokumentacionin e Shoqerise.

ORTAKU I VETEM

REDIN JEGENI

*Redin Jegeni*  
*Redin Jegeni*

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2610 Regj.

Nr. - Kol.

VERTETIM

Ne Tirane sot me date 21.05.2002(dymijedy) ne Zyren e Noterise Tirane, perpara meje noterit, u paraqit personalisht REDIN JEGENI, i biri i Suatit, i dtl. 28.04.1970, me banim ne Rr.Thanas Ziko, Nr. 19/1, Tirane, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta e tij Nr.0382028, i cili me cilesine e ortakut te vetem dhe te administratorit te Shoqerise "Ideart" shpk, nenshkroi me vullnetin e tij te lire e te plote Statutin e mesiperm dhe une noterit vertetoj nenshkrimin e tij.



NOTER

*Rejir Murat*  
*Rejir*



# AKT THEMELIMI

I

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Ideart" Sh .p .k.

Neni 1

REDIN JEGENI, i biri i Suatit, i dtl. 28.04.1970, me banim ne Rr.Thanas Ziko, Nr. 19/1, Tirane, krijon Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin "Ideart" Sh .p .k.

Neni 2

Shoqeria ka statusin e personit juridik dhe vulen e saj. Selia e saj eshte ne adresen, Rr.Thanas Ziko, Nr. 19/1, Tirane

Neni 3

Veprimtaria e shoqerise :

Marrdheniet qe lindin nga ky akt themelimi si dhe marrdheniet e saj me persona te trete fizike apo juridike shqiptare apo te huaj rregullohen sipas dispozitave te ketij akti themelimi, te statutit perkates dhe te ligjit Nr.7638, dt.19.11.1992 dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore qe rregullojne veprimtarine e subjekteve private.

Shoqeria pergjigjet vetem per pasurine e saj. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe merr Ortaku i vetem si person fizik tej veprimtarise se Shoqerise apo tej kapitalit themeltar te saj. Po keshtu Ortaku i vetem nuk pergjigjet per detyrimet e Shoqerise tej kapitalit te tij themeltar ne kete shoqeri.

Neni 4

Shoqeria ka per objekt te veprimtarise se saj :

Zhvillimin e aktivitetit tregtar ne fushen e krijimit, publikimit, shtypshkrimit dhe botimeve, botime keto si libra, revista, gazeta, botime shkollore dhe jashteshkollore, botime ne fushen e multim medias, botime informatike, duke bere te mundur prodhimin dhe distribuimin e Kasetave, Videokasetave, CD-ve, DVD-ve, etj.

Zhvillimin e aktivitetit tregtar ne fushen e publicitetit me anen e krijimit te agjensive publicitare, agjensi fotomodelesh, agjensi per organizimin e spektakleve te ndryshme dhe agjensi te tjera te te gjitha llojeve qe lidhen me publicitetin ne pergjithesi.

Te jape asistencë, ne rastet e kerkuara, per qendrat kulturore, bibliotekat e qyteteve dhe shkollave etj.

Veprimtari tregtare ne fushen e ushqimit social, hoteleri, etj.

Operacione tregtare e komisionerie dhe transakcione te ndryshme te çdo lloj malli.

Tregetim, Import-Eksport, me shumice e pakice te artikujve ushqimore, industriale, pajisje elektrike e elektroshtepiake, etj.  
Shoqeria mund te kryejte aktivite te tjera te lidhura ose plotesuese me ato te parat dhe cdo aktivitet tjeter te nevojshem ose te dobishem per qellimin shoqeror.

#### Neni 5

Prirmtaria e Shoqerise, emertimi dhe selia e saj te percaktuara ne kete akt themelimi nuk mund te ndryshojne pa vendim te Ortakut te vetem.

#### Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte ne shumen 100.000 Lek dhe i takon teresisht ortakut te vetem, i cili e ka ndare ate ne 10 kuota, ku secila kuote eshte ne shumen 10.000 Lek.

Keto kuota dhe mjetet e kapitalit themeltar te Shoqerise shenohen ne librin e llogarise se Shoqerise. Ato jane te shlyeshme dhe te nenshkrueshme dhe depozitohen ne nje nga bankat ne Shqiperi.

Ne librin e llogarise se Shoqerise krijohet "Fondi Themelor i Ortakut te Vetem". Ortaku i vetem nuk kufizohet ne rritjen e kontributit te kapitalit themeltar.

#### Neni 7

Jetegjatesia e Shoqerise eshte mbi 10 vjet, pervec ndonje zgjidhje tjeter te parakoheshme.

#### Neni 8

Fitimi i realizuar nga shoqeria pas zbritjes se detyrimeve ligjore dhe fondeve te percaktuara, merret nga Ortaku i vetem dhe perdoret sipas interesit te tij.

#### Neni 9

Organet e Shoqerise jane:

1. Ortaku i vetem ( )
2. Administratori
2. Komisioni i revizionit, ose i ekspertëve kontabel.

#### Neni 10

Dispozita me te hollesishme per Shoqerine, percaktohen ne Statutin e bashkangjitur ketij Akti Themelimi.

Neni 11

Ky Akt Themelimi u redaktua ne kater kopje nga te cilat njera dorezohet ne Zyren e Noterise, Tirane, nje tjeter ne Gjykatën e Rrethit Tirane, nje kopje ne Zyren e Tatimeve dhe një kopje mbahet ne dokumentacionin e Shoqerise.



ORTAKU I VETEM

REDIN JEGENI

A handwritten signature in cursive script, appearing to read "Redin Jegeni".

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 2610 Regj.

Nr. — Kol.

VERTETIM

Ne Tirane sot me date 21.05.2002(dymijedy) ne Zyren e Noterise Tirane, perpara meje noterit, u paraqit personalisht REDIN JEGENI, i biri i Suatit, i dtl. 28.04.1970, me banim ne Rr.Thanas Ziko, Nr. 19/1, Tirane, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta e tij Nr.0382028, i cili me cilesine e ortakut te vetem dhe te administratorit te Shoqerise "Ideart" shpk, nenshkroi me vullnetin e tij te lire e te plote aktin e mesiperm dhe une noteri vertetoj nenshkrimin e tij.



NOTER

A handwritten signature in cursive script, appearing to read "M. Murati".